

UDHËZIM
Nr. 3, datë 22.6.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 7, DATË 10.6.2020,
“MBI MODALITETET PËR TRANSFERIMIN E ZËVENDËSNOTERIT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 15, pika 6, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e ministrit të Drejtësisë nr. 7, datë 10.6.2020, “Mbi modalitetet për transferimin e zëvendësnoterit”, bëhen shtesat, si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Zëvendësnoteri ka të drejtë të transferohet pranë një noteri tjetër për të asistuar në ushtrimin e veprimtarisë noteriale, në rastet e mbylljes së zyrës noteriale pranë së cilës zëvendësnoteri ushtron funksionin, mosplotësimin të vendit vakant të noterit, si dhe në rastet kur paraqitet një kërkesë nga një noter për t’u asistuar përkohësisht nga një zëvendësnoter aktiv, sipas procedurës dhe rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 më përmbajtje, si më poshtë:

“2/1. Përveç rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij udhëzimi, transferimi mund të kryhet me afat të përcaktuar në aktin e transferimit, edhe:

a) me kërkesë të një noteri që ka nevojë të asistohet përkohësisht nga një zëvendësnoter aktiv;

b) me kërkesë të një noteri që do të asistohet nga zëvendësnoteri i emëruar më parë pranë një noteri tjetër, me të cilin zgjidhet kontrata e punës;

c) me kërkesë të Dhomës, për punësimin e zëvendësnoterit si menaxher ose asistent i kryetarit dhe/ose Këshillit të Dhomës, në kuptimin e nenit 66, të ligjit nr. 118/2018, “Për noterinë”.

Dhoma Kombëtare e Noterisë shqyrton dhe vendos mbi kërkesën e paraqitur, dhe njofton Ministrinë e Drejtësisë dhe degën vendore në të cilën ushtron veprimtarinë noteri.”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Monitorimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, noterët dhe zëvendësnoterët.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Toni Gogu